



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5703 prot.

Vlorë, më 16.04 2024

**PROJEKT VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2024

**PËR**

**NJË SAKTËSIM NË VENDIMIN NR. 6 DATË 29.01.2024, TË KËSHILLIT TË BASHKISË “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË PËRFITOJNË BANESË ME KOSTO TË ULËT NË APARTAMENTET E NDËRTUAR NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, NË LAGJEN “KUSHTRIMI” TEK ISH-FRIGORIFERI VLORË”**

Bazuar në nenin 112 pika 1 të Ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 54 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenin 3, 15, 16, 44 dhe 45, të Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” të ndryshuar; në nenin 52 të Rregullores së Këshillit Bashkiak Vlorë, në Vendimin nr. 87 datë 31.10.2023, të Këshillit Bashkiak Vlorë, “Për miratimin e Sistemit të Pikëzimit të së familjeve dhe individëve, që përfitojnë banesë me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave”; në Vendimin nr. 6 datë 29.01.2024, të Këshillit Bashkiak Vlorë, “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë banesë me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave, në lagjen “Kushtrimi” tek ish-frigoriferi Vlorë”; në kërkesën e Znj. Arjola Sinani depozituar pranë Këshillit dhe Administratës së Bashkisë me shkresën datë 10.04.2024, dhe E-Mailit në Platformën e Bashkëqeverisjes datë 05.04.2024, Këshilli i Bashkisë

**VENDOSI:**

1. Në Vendimin nr. 6 datë 29.01.2024, të Këshillit Bashkiak Vlorë, “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë banesë me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave, në lagjen “Kushtrimi” tek ish-frigoriferi Vlorë”, pika 2 pas emrit Arjola Maksim Sinani të shtohen pikët si më poshtë:
  - “Kushtet e strehimit”, pika 1.1/A - Nuk disponin apartament në pronësi, (5 pikë);
  - “Kushtet Familjare”, pika 1.2/A - Familje një prindërore që kanë në ngarkim një fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna (5 pikë);

- “Kushtet Familjare”, pika 1.2/D - Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhë se 40 vjeç (3 pikë);
  - “Kushtet e konomike”, pika 1.4/A - Familje me të ardhura brenda kufijvve të miratuar (25 pikë) . *(Miratuar me vendimin nr. nr. 6 datë 29.01.2024, të Këshillit Bashkiak Vlorë)*”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
  3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

**KRYETAR**  
**Elpiniqi Mërkuri**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

## RELACION

Mbi projektvendimin “Për një saktësim në Vendimin nr. 6 dt 29.01.2024 të Këshillit të Bashkisë” Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve që përfitojnë banesë me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave në lagjen “Kushtrimi” tek Ish-Frigoriferi Vlorë”

Të nderuar Këshilltarë

Sikurëse jeni në dijeni në vendimin nr. 6 dt 29.01.2024 kemi miraturar listën e familjeve dhe individëve që përfitojnë banesa sociale me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave. Në listën në pritje të paraqitur nga Administrata e Bashkisë për apartamentet 1+1, Këshilli i Bashkisë shtoi edhe Znj. Arjola Maksim Sinani duke vlerësuar kushtet specifike si dhe plotësimin e kritereve. Ndërkohë në shkresën e përcjellë Entit Kombëtar të Banesave pavarësisht vendimit të Këshillit në emër të Znj. Arjola Maksim Sinani janë pasqyruar vetëm 10 pikë duke mos llogaritur edhe pikët për kushtet ekonomike dhe si familje e re.

Në kushte të tilla e interesuara ka depozituar një kërkesë Administratës së Bashkisë, Platformës së Bashkëqeverisjes si dhe Entit Kombëtar të Banesave që të llogariten edhe pikët për kushtet ekonomike për sa cituam më lartë bazuar edhe në nenin 3 të Ligjit nr. 22/2018 dt 03.05.2018 “Për strehimin social “Parimi i Përbalueshmërisë” i cila nga Administrata e Bashkisë nuk është marrë parasysh.

Nga komunikimi me Entin Kombëtar të Banesave rezulton se në mënyrën si është përcjellë vendimi nr. 6 dt 29.01.2024 i Këshillit të Bashkisë për këtë institucion me vlerësimin 10 pikë nuk mund të trajtohet.

Nga sa më lartë nëpërmjet këtij projektvendimi kërkohet të saktësohet formulimi i pikës 2 të vendimit nr. 6 dt 29.01.2024 duke e bërë vlerësimin në pikë për Znj. Arjola Maksim Sinani sikurëse është pasqyruar në projektvendim.

Theksojmë se ky saktësim është i domosdoshëm për vijimin e procedurave të mëtejshme nga Enti Kombëtar i Banesave.

**KRYETAR**

**Elpiniqi Mërkuri**

